



REPUBLIKA E KOSOVË
KOMUNA DRENAS

DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM

KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	17.08.		2020
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
09	644/01	32	581



Nr 644/01-32581
Datë: 17.08.2020

Mbështetur në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, në Ligjin për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068 si dhe në UA nr. 22/2013 për numrin maksimal të nxënësve në klasë dhe raportin mësimdhënës-nxënës, dhe Vendimin e MASH-it nr.01B-69, dt.06.08.2020 për kushtet dhe kritret e regjistrimit në klasën e 10-të, Drejtoria e Arsimit shpall:

K O N K U R S

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË SHKOLLA TË MESME TË LARTA- NË GJIMNAZIN " GJ.K.SKËNDËRBEU" DHE NË SHMP " FEHMI LLADROVCI " NË DRENAS PËR VITIN SHKOLLOR 2020/2021

Konkursi shpallet me këto kushte dhe kritere:

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2020/21, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave ose diplomës në MASH dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)

Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe

Certifikatën e lindjes.

Shkolla duhet të krijoj kushte për mbajtjen e distanës së nxënësve gjatë aplikimit të tyre.

Sqarim: Drejtimit për shkolla janë sipas Kornizës së Kurrikulit të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës

Numri i nxënësve që do pranohen në dy shkollat e mesme të larta në Drenas është në tabelat më poshtë.

Gjimnazi “ Gj.K.Skëndërbeu ” Drenas

Nr.	Drejtimi	Nr. paraleleve	Nr. nxënësve
1	Drejtimi Shoqëror-Gjuhësor	6	150
2	Drejtimi Shkenca natyrore	8	200

SHMP "FEHMI LLADROVCI" Drenas

Nr.	Drejtimi	Profili Arsimit	Nr. I paraleleve	Nr. I nxënësve
1	MAKINERI	Ngrohje dhe Klimatizim	2	50
		Transport rrugor	2	50
		Automekanik	1	25
		Saldator	1	25
2	ELEKTROTEKNIKË	Teknik I elektroteknikes	1	25
		Mekatronikë	1	25
		Teknik i Informatikës	1	25
		Teknik I Telekomit	1	25
3	EKONOMI	Kontabilist	2	50
		Banka e Sigurime	1	25
4	KIMI TEKNOLOGJI	Teknik Ri qarkullimit	1	25
		Laborant i Kimisë	1	25
		Teknologji Ushqimore	1	25
5	BUJQËSI	Hortikulturë	1	25
6	NDERTIMTARI	Arkitekturë	1	25
7	MJEKSI	Farmaci	1	25
		Infermieri	1	25
8	KONFEKSION	Konfeksion-Dizajn	1	25
9	GJEOLGJI	Teknik I gjeologjisë	1	25
10	METALURGJI	Përfitues i Metaleve	1	25
		TOTALI	23	575

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2020/2021, bëhet më datën **17-21 gusht 2020** në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora **8.00-16.00**.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën **24 gusht 2020**. Në shkollat ku nuk plotësohet numri i nxënësve aplikimi i nxënësve mund të vazhdojë deri më **26 gusht 2020**.

Shpallja e rezultateve më **28 gusht 2020** dhe kthimi i dokumenteve deri më **31 gusht 2020**. Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej **24-31 gusht 2020**.

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda **24 orëve**, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kritere:

1. Nota mesatare e të gjitha lëndëve (klasat 6-9) (60 %) 60 pikë
2. Nota mesatare nga lëndët prioritare (klasat -9) (40 %) 40 pikë

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4 e më lartë (Së pari gjendet mesatarja e 4 lëndëve prioritare veq veq, pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

Lëndet prioritare për drejtimet përkatëse:

Shkencat shoqërore dhe gjuhësore:

Lënda I - *Gjuhë amtare;*

Lënda II - *Gjuhë angleze;*

Lënda III- *Histori;*

Lënda IV – *Gjeografi.*

Shkencat natyrore:

Lënda I- *Fizikë;*

Lënda II - *Kimi;*

Lënda III – *Biologji;*

Lënda IV- *Matematikë.*

Renditja e lëndëve me prioritete sipas profileve në shkolla profesionale
Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari

Lënda I- Fizikë;
Lënda II - Kimi;
Lënda III – Biologji;
Lënda IV- Gjuhë amtare.

Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi – Teknologji

Lënda I- Fizikë;
Lënda II - Kimi;
Lënda III – Matematikë;
Lënda IV- TIK.

Ekonomi

Lënda I - *Gjuhë amtare*;
Lënda II - Gjeografi;
Lënda III- Matematikë;
Lënda IV – TIK.

Juridik, Tregti, Hotileri dhe Turizëm

Lënda I - *Gjuhë amtare*;
Lënda II - Gjuhë angleze;
Lënda III- Histori;
Lënda IV – Gjeografi

Në rast se nuk mund të bëhet pranimi ngase kandidatët kanë pikë të barabarata do të merren parasysh edhe këto kritere shtesë.

Suksesi në klasat 1-5 mbildhet nota mesatare e 5 viteve dhe pjesëtohet me 5 pikë.

Nëse prap kanë pikë të barabarta merren parasysh këto kritere:

1. Pjesëmarrja në gara ndërkombëtare të diturisë.....5 pikë
2. Vendi i parë në gara shtetërore të diturisë.....5 pikë
3. Vendi i dytë në gara shtetërore të diturisë.....4 pikë
4. Vendi i tretë në gara shtetërore të diturisë.....3 pikë
5. Vendi i parë në gara komunale të diturisë.....3 pikë
6. Vendi i dytë në gara komunale të diturisë.....2 pikë
7. Vendi i tretë në gara komunale të diturisë.....1 pikë

Nëse shkolla edhe me këto kritere shtesë nuk mund të bëjë përzgjedhjen e kandidatëve me pikë të barabartë, atëherë shkolla për këta kandidatë organizon vlerësim apo testim.



**Direktori i DKA-së
Muhamed Gjoka**